

**VENDIM**  
**Nr.132, datë 9.3.2005**

**PËR MIRATIMIN NË PARIM TË RITJES SË KAPITALIT TË AUTORIZUAR DHE TË NËNSHKRUAR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË BANKËN ISLAMIKE PËR ZHVILLIM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7740, datë 21.7.1993 “Për ratifikimin e marrëveshjes së anëtarësisë të Republikës së Shqipërisë në Bankën Islamike për Zhvillim” dhe të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI;**

1. Miratimin në parim të rritjes së kapitalit të autorizuar dhe të nënshkruar të Republikës së Shqipërisë në Bankën Islamike për Zhvillim për shumën ekuivalente në USD të shumës 2 460 000 (dy milionë e katërqind e gjashtëdhjetë mijë) dinarë islamikë dhe marrjen përsipër të këtij detyrimi financiar.

2. Ministria e Ekonomisë të parashikojë në buxhetin vjetor, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, fondin përkatës për përballimin e pagesës së këtij detyrimi për rritjen e kapitalit, sipas kërkesave dhe në përputhje me marrëveshjen që do të nënshkruhet për këtë qëllim me Bankën Islamike për Zhvillim.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**

**REZOLUTA NR.BG/5-422**

**MBI RITJEN E KAPITALIT TË AUTORIZUAR DHE TË NËNSHKRUAR NË BANKËN ISLAMIKE PËR ZHVILLIM**

(Miratuar në seancën plenare të mbledhjes së 26-të vjetore të zhvilluar në datën 8 sha’ban 1422, që i korrespondon datës 24 tetor 2001)

Bordi i guvernatorëve,

*duke marrë* në konsideratë rezolutën nr.40/9-E(JS) të miratuar në konferencën e nëntë të samitit islamik lidhur me rritjen e aksioneve të kapitalit të autorizuar dhe të nënshkruar të Bankës;

*duke marrë* në konsideratë raportin e bordit të drejtorëve ekzekutivë të përfshirë në dokumentin nr.BED/BG/5-422;

*duke pranuar* nevojën për rritjen e kapitalit të Bankës, me qëllim mbajtjen e gjendjes financiare të fuqishme dhe mundësimin e rritjes së burimeve nga tregu për të financuar veprimtarinë e saj;

*duke marrë* parasysh nenet 4, 5(4), 5(6) 7,21 dhe 29 të Marrëveshjes;  
vendosi si më poshtë:

1. Aksionet e kapitalit të autorizuar të Bankës do të rriten nga nëntë miliardë dinarë islamikë (ID 9.000.000.000) në pesëmbëdhjetë miliardë dinarë islamikë (ID15.000.000.000). Kjo rritje do të ndahet në nëntëqind mijë aksione (900.000), çmimi nominal i çdo aksioni do të jetë dhjetë mijë dinarë islamikë (ID 10.000).

2. Aksionet e kapitalit të nënshkruar të Bankës do të rriten nga katër miliardë dinarë islamikë (ID 4.000.000.000) në tetë miliardë e njëqind milionë dinarë islamikë (ID 8.100.000 000). Kjo rritje do të ndahet në katërqind aksione (400.000) me çmim nominal të çdo aksioni dhjetë mijë dinarë islamike (ID 10.000), ku të gjitha këto aksione do të jenë të thirrura.

3. Rritja në stokun e kapitalit të nënshkruar të Bankës do të jetë e vlefshme për t’u nënshkruar nga vendet anëtare, sipas termave dhe kushteve të mëposhtme:

i) Çdo vend anëtar do të ketë të drejtën për të nënshkruar pjesën e rritjes së stokut të kapitalit

të Bankës, të barabartë me pjesën, stoku i së cilës është nënshkruar deri tani, duke pasur parasysh stokun e kapitalit aktual të nënshkruar në momentin para datës së kësaj rezolute.

ii) Çmimi i çdo aksioni të nënshkruar do të jetë dhjetë mijë dinarë islamikë (ID 10.000), siç është përmendur më lart.

iii) Sipas kësaj rezolute, aksionet e nënshkruara nga vendet anëtare do të jenë subjekt i thirrjes së Bankës vetëm në rast se këtë e kërkon Banka për të përmbushur detyrimet e saj, që rezultojnë nga rritja e fondeve nga tregu ose garancitë e dhëna nga operacionet e saj të zakonshme. Nëse do të ketë kërkesa për aksione, ato do të realizohen në valutë të konvertueshme e të pranueshme nga Banka dhe do të jenë uniform në përqindje për të gjitha aksionet e thirrura.

iv) Vendi anëtar nënshkrues i kësaj rritjeje do të ketë një votë për çdo aksion të nënshkruar.

v) Çdo vend anëtar që dëshiron të nënshkruajë rritjen e kapitalit duhet të njoftojë zyrtarisht Bankën për numrin e kapitaleve që dëshiron të nënshkruajë jo më vonë se gjashtë muaj pas datës së kësaj rezolute; duke siguruar që me kërkesë të një anëtari, bordi i drejtorëve ekzekutivë duhet të lejojë një periudhë të mëtejshme për një njoftim të tillë. Mungesa e një njoftimi zyrtar nga çdo vend anëtar do të konsiderohet si tërheqje e këtij vendi nga nënshkrimi i rritjes së stokut të kapitalit të Bankës.

vi) Çdo vend anëtar që dëshiron të nënshkruajë këtë rritje të kapitalit të Bankës, do t'i prezantojë Bankës se ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të autorizuar një nënshkrim të tillë dhe do t'i sigurojë Bankës një informacion sipas kërkesës së saj.

4. Subjekt i dispozitave të kësaj rezolute, nenet e Marrëveshjes së Bankës do të zbatohen për të gjitha aksionet e autorizuara, si dhe për të gjitha detyrimet dhe pagesat e kryera sipas kësaj rezolute.